KËRKESË
Nr.2666/1, datë 30.4.2008

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rrëshen – Kalimash".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga grupi i punës ngritur për këtë qëllim, vlerësim i cili është miratuar më pas nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ju bëjmë në dije që vlerësimi i objekteve është bërë në bazë të zërave të punimeve të evidentuara dhe të dokumentuara në prezencë të pronarëve, të cilët kanë firmosur më pas procesverbalet respektive. Ndërsa çmimet për çdo zë punimi janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave, kjo në mbështetje të akteve ligjore të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private, për interes publik.

Të gjithë pronarët, për të cilët në kolonën "shënime" në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Proces regjistrimi", do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (Subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private, për interes publik").

Pronarët, për të cilët në kolonën "shënime" në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 47 415 531 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë.

LISTA E PRONAREVE PASURITE (OBJEKTE) NE PRONESI TE TE CILEVE PREKEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRESHEN - KALIMASH

NR.	EMRI	PRONARI ATESIA	MBIEMRI	NR. PASURISE	VLERA LEKE	FSHATI	SHENIME
1	PRENG	GJON	MARPEPA	173	1939220	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
2	NDUE	NIKOLL	NDOJ	200	4172486	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
3	ARDIAN	FRAN	PRENGA	143	462661	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
4	NDUE	FRROK	MARKU	170	2261755	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
5	AGUSTIN	ZEF	MARKU	43/1	2054356	SHTRUNGAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
6	PASHK	DED	NIKOLLI	59/7	1783282	SHTRUNGAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
7	GEZIM	MARK	GJOKA	81/11	1803086	SHTRUNGAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
8	RROK	GJET	GJERGJI		1240632	ZALL-XHUXH	PROCES REGJISTRIMI
9	MARTIN	NDUE	GJETA	30	2197050	ZALL-XHUXH	KONFIRMUAR NGA ZRPP
10	ZEF	LLESH	MENA	206	2929735	ZALL-XHUXH	KONFIRMUAR NGA ZRPP
11	ZEF	NDUE	KARACI	193	2588396	ZALL-XHUXH	KONFIRMUAR NGA ZRPP
12	SHKELZEN	DED	PRENDI	88/2	418025	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
13	MEHILL	KOL	GJOKA	112/4	1510837	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
14	NDUE	MEHILL	GJOKA	112/5	2432437	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
15	PAULIN	DED	PRENDI	88/5	397917	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
16	NIKOLL	NDUE	GJERGJI		1880330	SANG	PROCES REGJISTRIMI

17	DED	NDUE	NDOJ	161	1837939	SANG	KONFIRMUAR NGA ZRPP
18	NDUE	PRENG	PRENGA		1216783	SANG	PROCES REGJISTRIMI
19	GJOK	NDUE	NDOJ	162	2091319	SANG	KONFIRMUAR NGA ZRPP
20	GJERGJ	ZEF	NDRECA	69/3	1546731	KLOS	KONFIRMUAR NGA ZRPP
21	CUP	NIKOLL	BOCI		1426955	KLOS	PROCES REGJISTRIMI
22	KOL	NDUE	LLESHI	88/6	3493059	KLOS	KONFIRMUAR NGA ZRPP
23	DAVA	NIKOLL	TUCI	84/5	2021959	KLOS	KONFIRMUAR NGA ZRPP
24	PASHK	FRROK	NIKOLLI	144/1	1313121	GEZIQ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
25	GJET	NIKOLL	PERSHQEFA	60	2395460	BISAK	KONFIRMUAR NGA ZRPP
		TOTALI			**47415531**		